| | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 4. b. | 3.b. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin "profesor i asociuar", | Vërtetimi i përvojës minimale 5-vjeçare si personel akademik me kohë të plotë me ose pa ndërprerje ose me kohë të | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | duhet:<br>c) të ketë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë, së paku, 5 (pesë)- vjeçare, me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme si lektor, për një periudhë 8 (tetë)-vjeçare akademike, me apo pa ndërprerje. | pjesshme për 8 vjet me ose pa ndërprerje. | |
| | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 4.c.<br><br>Statuti i UART.<br>Rregullorja e UART. | 3.c. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin "profesor i asociuar", duhet:<br>c) të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle ose të mbrojë veprimtarinë kërkimore botuese përpara Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në një nga gjuhët e mësipërme, | Vërtetimi i zotërimit të njërës (të paktën) nga 5 gjuhët e huaja (angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle) ose te mbrojë veprimtarine kerkimore-shkencore perpara KPPA-së në një nga ato gjuhë. | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | në përputhje me statutin dhe rregulloren e UART. | | |
| | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 5. a. | 4.a. Personeli akademik, që aplikon për titullin "profesor i asociuar", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:<br>a) Ka botuar, së paku, 5 (pesë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 2 (dy) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi te Journal Citation Report (JCR), faktor | Dokumentimi i 5 (pesë) (së paku) artikujve shkencorë të botuar në revista të indeksuara, sipas kërkesave;<br>Dokumentimi i 2 (dy) artikujve të botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara, sipas kërkesave.<br><br>Dokumentimi i 3 (tre) artikujve të botuar në revista vendore të njohura nga MAS dhe AKSHI. | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI). | | |
| | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 5. b. | 4.b. Personeli akademik, që aplikon për titullin "profesor i asociuar", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:<br>b) Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku, 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "*Proceedings*", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN. | Dokumentimi i renditjes si autor i parë në 5 referime (së paku);<br>Dokumentimi i 2 referimeve në aktivitetin (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të BE-së, OECD, G20 dhe të publikuara;<br>Dokumentimi i vlerësimit paraprak dhe i botimit në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.<br>Dokumentimi i 3 (tre) referimeve në veprimtari kombëtare. | |
| | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 5/1. | 4/1. Bëjnë përjashtim nga shkronjat "4.a." dhe "4.b." më sipër (apo 5.a/5.b të kreut II të VKM-së), | Listë e veprimtarisë artistike-kërkimore-shkencore e kandidatit. | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë me status të veçantë, me veprimtari në fushën e arteve.<br>Personeli akademik në fushën e arteve, që aplikon për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar", zhvillon veprimtari kërkimore shkencore në fushën e krijimtarisë artistike, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:<br>a) Për kompozitorët, krijime të veprave të luajtura në skena që përfshijnë formën e sonatës ciklike (vepra me më shumë se 2 kohë) ose vokalo sinfonike.<br>b) Për instrumentistët, interpretime vepër/a solistike në formën e sonatës ose ciklike (vepra me më shumë se 2 kohë).<br>c) Për këngëtarët lirikë, | Dokumentimi, sipas kërkesave për secilën kategori, i marrjes pjesë në 5 (pesë) (së paku) realizime artistike, në evente të njohura kombëtare ose ndërkombëtare, ku së paku 2 (dy) nga veprat të jetë luajtur me trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike, regji apo role, në shfaqje/filma etj., ose veprimtari ekuivalente në artet pamore dhe të aplikuara) në veprimtari ndërkombëtare, (festival, sezone).<br>Dokumentimi se vepra/performanca është pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, është botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe është shoqëruar me kritikën | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | interpretime në rol kryesor në opera.<br>d) Për dirigjentët, drejtim në skenë vepra sinfonike, ciklike (vepra me më shumë se 2 kohë), vokalo-sinfonike ose opera.<br>e) Për aktorët, interpretime në role kryesore në teatër ose në film.<br>f) Për regjisorët, vendosje në skenë të veprave teatrore, filmike, ose televizive.<br>g) Për skenografët/kostumografët, vendosja në skenë e shfaqjeve teatrore, televizive, operistike/balet ose në film artistik.<br>h) Për krijuesit e arteve pamore dhe të aplikuara, hapja e ekspozite personale, krijimi i veprave publike monumentale ose perfomancë artistike pamore, në arenën kombëtare. | përkatëse profesionale. | |

REPUBLIKA E SHQIPERISË UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | i) Për koreografët, vendosje në skenë vepër baleti ose performancë në televizion.<br>j) Për balerinët, interpretime në role kryesore në skenë në balet ose të performancës në televizion.<br>Secila nga kategoritë e përcaktuar në këtë pikë duhet të kenë marrë pjesë, së paku në 5 (pesë) realizime artistike si solist, vepra, ekspozita, vënie në skenë apo role të spikatura në veprimtari (festivale, sezone, etj.) të njohura kombëtare ose ndërkombëtare, ku së paku, 2 (dy) nga veprat të jetë luajtur me trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike, regji apo role, në shfaqje/filma etj., ose veprimtari ekuivalente në | | |

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | artet pamore dhe të aplikuara) në një veprimtari ndërkombëtare (festival, sezone).<br>Vepra/performanca të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak dhe të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse profesionale. | | |
| 5. Monografitë dhe ekuivalentimi | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 6.a. | 5.a. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 5, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon që vijon:<br>a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore "doktor", brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të | Dokumentimi i një monografie të botuar pas mbrojtjes së gradës "Doktor", të vlerësuar nga dy vlerësues, të pranuar nga njësia bazë.<br><br>Vërtetimi se monografia e botuar jashtë, është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I ARTEVE - TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga *SENSE Ranking of Academic Publishers,* në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) "profesorë" të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet anëtare të BE-së, | Vërtetimi se monografia e botuar brenda është e vlerësuar nga një profesor i vendit dhe një nga vendet e BE-së, OECD-së ose G20-ës. | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | OECD-së ose G20-ës. | | |
| | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 6. b. | 5.b. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 5, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon që vijon:<br>b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:<br>i) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;<br>ii) 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit te Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI). | Raporti i njësisë kryesore dhe bazë konfirmon ekuivalentimin sipas pikës përkatëse. | |
| | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 6.c. | 6.c. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e | Raporti i njësisë kryesore dhe bazë konfirmon ekuivalentimin sipas pikës | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 5, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon që vijon:<br>c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:<br>i) 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;<br>ii) 2 (dy) artikuj shkencorë që janë botuar në revistë ndërkombëtare e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit te Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI). | përkatëse. | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 6. Angazhimi dhe aktiviteti i aplikantit, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor" | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 7.a-ë. | 6. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor" në:<br>a) komitete shkencore apo borde editoriale;<br>b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;<br>c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;<br>ç) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;<br>d) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;<br>dh) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;<br>e) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;<br>ë) projektet e transferimit | Vërtetimi i anëtarësisë në komitete shkencore apo borde editoriale;<br>Vërtetimi i pjesëmarrjes ne veprimtari vlerësues si anetar komiteti ose bordi editoriale;<br>Vërtetimi i pjesëmarrjes në projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori, ose anëtari;<br>Vërtetim i përfitimit të financimeve me konkurrim në nivel kombëtar e ndërkombëtar;<br>Vërtetimi angazhimit në rolin e koordinatorit të projektit të financuar nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin;<br>Vërtetim i qenies vlerësues për projekte kombëtare e | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | teknologjik të patentave. | ndërkombëtare;<br>Vërtetimi i angazhimit si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;<br>Vërtetim i pjesëmarrjes në projektet e transferimit teknologjik të patentave. | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 7. Ekuivalentimi nga KPPA-ja i angazhimit dhe i pjesëmarrjes së aplikantit në veprimtaritë e pikës 7. | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 8.a-b.<br><br>VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 9. | 7.a. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 7, të këtij kreu, mund të ekuivalentohet me:<br>a) 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit te Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI);<br>b) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit dhe 2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "*Proceedings*", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN. | Raporti i njësisë bazë, që konfirmon angazhimin në veprimtaritë e parashikuara në pikën 7 dhe në zbatim të kushtëzimeve të pikës 8. | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 8. Niveli sasior i treguesve, të përcaktuar në pikën 7 të këtij kreu, si dhe vlera përkatëse e tyre parashikohen në rregulloren përkatëse të IAL-ve dhe vendosen në funksion të prioriteteve akademike e strategjike të tyre. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në pikën 7 të këtij kreu, hartohet nga njësia bazë e njësia kryesore dhe miratohet nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik. | | |
| 9. Studimet postdoktorale | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 10. | 10. Në rastet kur kandidati ka realizuar studim postdoktoratë në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, me një kohëzgjatje, të paktën, 6 (gjashtë) muaj, shoqëruar me raport të detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë kësaj periudhe, ai ekuivalentohet me 1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti dhe 1 (një) referim të mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga | Raporti i aplikantit për studimet postdoktorale shoqëruar me dokumentacionin e lëshuar nga institucioni pritës. | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "*Proceedings*", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN. | | |
| 10. Vlefshmëria e aktivitetit shkencor | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 11. | 9. Për fitimin e titullit akademik "profesor i asociuar", botimet shkencore/aktivitetet artistike të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së gradës shkencore "doktor", deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik "profesor i asociuar". | Dokumentimi se aktiviteti shkencor/artistik është brenda 2 datave limit. | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I ARTEVE - TIRANË

# SKEDA E KPPA PËR TITULLIN "PROFESOR I ASOCIUAR NË ARTE"

| Aktiviteti dhe standardet | Referenca rregullatore | Kërkesat për fitimin e titullit "Profesor i asociuar në arte" | Dokumentet që paraqiten | Realizimi |
|---|---|---|---|---|
| 1. Lektrimi, përvoja në rolet akademike e aplikantit | Statuti i UART; Rregullorja e KPPA e UART. | 1.a. Personeli akademik me kohë të plotë pranë Universitetit të Arteve, që aplikon për titullin "profesor i asociuar në arte", duhet:<br>a) Të ketë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë, së paku, 5 (pesë) vjeçare, me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme, për një periudhë 8 (tetë) vjeçare akademike, me apo pa ndërprerje.<br>Personeli akademik që ka përvojë akademike me kohë të plotë më të ulët se 5 vite, por ka përvojë si personel akademik me kohë të pjesshme më të ulët se 8 (tetë) vite, koha e pjesshme i konvertohet si vite me kohë të plotë, e cila përllogaritet me një koeficient prej 1.6 vite kohë e pjesshme, e konvertuar në 1 (një) vit përvojë pune me kohë të plotë. | Dokumenti që vërteton përvojën në punë sipas afateve të përcaktuara. | |
| | Statuti i UART; Rregullorja e KPPA e UART. | 2.b. Personeli akademik me kohë të plotë pranë Universitetit të Arteve, që | Vërtetimi përkatës i përditësuar nga Njësia Bazë për aftësitë në mësimdhënie. | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I ARTEVE - TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | aplikon për titullin "profesor i asociuar në arte", duhet:<br>b) Të gëzojë aftësi të mira në mësimdhënie, vlerësuar nga Njësia Bazë përkatëse. | | |
| | Statuti i UART;<br>Rregullorja e KPPA e UART.<br>. | 2.c. Personeli akademik me kohë të plotë pranë Universitetit të Arteve, që aplikon për titullin "profesor i asociuar në arte", duhet:<br>c) Të njohë një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle, vërtetuar nëpërmjet dëshmisë përkatëse, në përputhje me statutin dhe rregulloren e UART. | Vërtetimi (dëshmia) për njohjen e (të paktën) njërës prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja. | |
| 4. Zotërim i plotë i fushës artistike-kërkimore-shkencore | Statuti i UART;<br>Rregullorja e KPPA e UART. | 3.a. Personeli akademik me kohë të plotë pranë *Fakultetit të Muzikës*, që aplikon për titullin "profesor në arte", ekuivalent me "profesor" duhet të ketë zhvilluar veprimtarinë kërkimore | Listë e veprimtarisë artistike-kërkimore-shkencore e kandidatit.<br><br>Dokumentimi i pjesëmarrjes në së paku 5 (pesë) realizime artistike të veprimtarive artistike të | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | shkencore në fushën e krijimtarisë artistike, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:<br>a) Për kompozitorët, duhet të kenë krijuar vepra të luajtura në skena që përfshijnë formën e sonatës/ciklike me përmbajtje të ndryshme instrumentale/vokalo sinfonike;<br>b) Për dirigjentët, duhet të kenë drejtuar koncerte të plota në të cilat të jenë interpretuar vepra që përfshijnë formën e sonatës/ciklike/ me përmbajtje të ndryshme instrumentale/vokalo simfonike;<br>c) Për instrumentistët, duhet të kenë interpretuar vepër/a solistike (në ansambël/orkestër solist) në formën e sonatës ose ciklike;<br>d) Për këngëtarët, duhet të | njohura kombëtare ose ndërkombëtare, ku së paku, 2 (dy) prej veprave janë me angazhim ndërkombëtar.<br><br>Vërtetimi për udhëheqjen e diplomave apo shoqërimit në rolin e instrumentistit shoqërues, sipas kërkesave. | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I ARTEVE - TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | kenë interpretuar role kryesore në opera.<br><br>Secila nga kategoritë e përcaktuara duhet të kenë marrë pjesë, së paku në 5 (pesë) realizime artistike si solist, vepra, ekspozita, vënie në skenë apo role të spikatura në veprimtari (festivale, sezone, etj.) të njohura kombëtare ose ndërkombëtare, ku së paku, 2 (dy) nga veprat të jetë luajtur me trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike, regji apo role, në shfaqje/filma etj., ose veprimtari ekuivalente në artet pamore dhe të aplikuara) në një veprimtari ndërkombëtare (festival, sezone). | | |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI I ARTEVE - TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Për Fakultetin e Muzikës, aplikanti nga cilado prej kategorive të mësipërme, duhet të ketë udhëhequr, së paku 5 (pesë) diploma të nivelit Bachelor ose Master, ose të ketë shoqëruar, në rolin e instrumentistit shoqërues sipas ngarkesës mësimore, 50 diploma. | | |
| | | 3.b. Personeli akademik me kohë të plotë pranë Fakultetit të Arteve të Bukura, që aplikon për titullin "profesor në arte", ekuivalent me "profesor" duhet të ketë zhvilluar veprimtarinë kërkimore shkencore në fushën e krijimtarisë artistike, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:<br>a) Për krijuesit e arteve pamore dhe të aplikuara, hapja e ekspozite personale, krijimi i veprave publike monumentale ose perfomancë artistike pamore, në arenën kombëtare. | Dokumentimi i pjesëmarrjes në së paku 5 (pesë) realizime artistike të veprimtarive artistike të njohura kombëtare ose ndërkombëtare, ku së paku, 2 (dy) prej veprave janë me angazhim ndërkombëtar. | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Aplikanti (krijues i arteve pamore/të aplikuara) duhet të kenë marrë pjesë, së paku në 5 (pesë) realizime artistike si solist, vepra, ekspozita, vënie në skenë apo role të spikatura në veprimtari (festivale, sezone, etj.) të njohura kombëtare ose ndërkombëtare, ku së paku, 2 (dy) nga veprat të jetë luajtur me trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike, regji apo role, në shfaqje/filma etj., ose veprimtari ekuivalente në artet pamore dhe të aplikuara) në një veprimtari ndërkombëtare (festival, sezone). | | |
| | | 3.c. Personeli akademik me kohë të plotë pranë Fakultetit të Artit Skenik, që aplikon për titullin "profesor në arte", ekuivalent me "profesor" duhet të ketë zhvilluar veprimtarinë | Dokumentimi i pjesëmarrjes në së paku 5 (pesë) realizime artistike të veprimtarive artistike të njohura kombëtare ose ndërkombëtare, ku së paku, | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | kërkimore shkencore në fushën e krijimtarisë artistike, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:<br><br>a) Për aktorët, interpretime në role kryesore në teatër ose në film.<br>b) Për regjisorët, vendosje në skenë të veprave teatrore, filmike, ose televizive.<br>c) Për skenografët/kostumografët, vendosja në skenë e shfaqjeve teatrore, televizive, operistike/balet ose në film artistik.<br>d) Për koreografët, vendosje në skenë vepër baleti ose performancë në televizion.<br>e) Për balerinët, interpretime në role kryesore në skenë në balet ose të performancës në televizion.<br><br>Secila nga kategoritë e përcaktuara më sipër, duhet të kenë marrë pjesë së paku në 5 (pesë) realizime artistike si solist, vepra, | 2 (dy) prej veprave janë me angazhim ndërkombëtar. | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I ARTEVE - TIRANË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | ekspozita, vënie në skenë apo role të spikatura në veprimtari (festivale, sezone, etj.) të njohura kombëtare ose ndërkombëtare, ku së paku, 2 (dy) nga veprat të jetë luajtur me trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike, regji apo role, në shfaqje/filma etj., ose veprimtari ekuivalente në artet pamore dhe të aplikuara) në një veprimtari ndërkombëtare (festival, sezone). | | |
| 5. Vlefshmëria e aktivitetit | Statuti i UART; Rregullorja e KPPA e UART. | 4. Vënia në skenë e veprave/pjesëmarrja/drejtimi, do të marren në konsideratë vetëm 1 (një) herë dhe vetëm në rastet kur nuk janë përdorur për fitimin e diplomave, gradave apo titujve të mëparshëm pranë institucioneve të arsimit të lartë. | Vetëdeklarim se veprat/pjesëmarrja/drejtimi nuk janë përdorur më parë për fitimin e diplomave, gradave apo titujve të mëparshëm pranë IAL-ve. | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I ARTEVE - TIRANË